

UDHËZIM
Nr. 10, datë 1.6.2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 14.2.2013,
“PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT SHKENCOR DHE TË
PANELEVE SHKENCORE PRANË AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 66, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar, dhe të VKM-së nr. 708, datë 9.9.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”,

UDHËZON:

Neni 1

1. Pika 6 e udhëzimit, riformulohet si më poshtë vijon:

“6. Komiteti dhe panelet shkencore përbëhen nga ekspertë me kualifikim akademik, mbajtës të titullit profesor i asociuar ose doktor shkencash, si dhe me arritje profesionale në fushat shkencore të cilat lidhen me sigurinë ushqimore. Komiteti ka në përbërje të tij 5 anëtarë, ndër të cilët 2 janë kryetarët e paneleve. Panelet kanë në përbërje të tyre 3 anëtarë”.

2. Pika 16 e udhëzimit, riformulohet si më poshtë vijon:

“16. Mbledhja e Komitetit është e vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë”.

3. Pika 21 e udhëzimit, riformulohet si më poshtë vijon:

“21. Sektori i Aktivitetit Shkencor dhe Komunikimit me RASFF.”

Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca**